



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 11, datë 10/03/2004

MBI
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK
NR. 87, DT. 22.11.2002
“PËR STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË APARATIT TË BASHKISË”

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32, gërma “ç”, Ligjit Nr.8549, dt.11/11/1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.87, dt.22/12/2002 “Për Strukturën Organizative të Aparatit të Bashkisë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.24, dt.30/07/2003 “Për një shtesë në strukturën organizative të Bashkisë Tiranë, miratuar me VKB Nr.87, dt.22/11/2002” pas shqyrtimit të Relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 87, datë 22.12.2002 “Për Strukturën Organizative të Aparatit të Bashkisë”, sipas Pasqyrës Nr. 1 bashkëlidhur.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, miratohet struktura organizative e Bashkisë së Tiranës, sipas organigramës bashkëlidhur.
3. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 24, datë 30.07.2003 ndryshon si vijon:
“Numri maksimal i punonjësve të Aparatit të Bashkisë së Tiranës është:

- Punonjës funksionar dhe nëpunës civilë	-	315
- Punonjës me kontratë	-	70”

4. Efektet financiare të këtij Vendimi të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI